



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 194, datë 29.12.2025

**PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË SHOQËRISË AUDITUESE, PËR
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE, PËR VITIN 2025**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e kriterëve të përzgjedhjes së shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2025, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI**

Kriteret e përzgjedhjes së shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2025, si më poshtë:

- a. Të jetë i regjistruar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) për të ushtruar veprimtarinë në Shqipëri;
- b. Të jetë i regjistruar në regjistrin publik si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë dhe të ketë reputacion ndërkombëtar;
- c. Ofertuesi duhet të jetë kontrolluar dhe të ketë marrë notë jo më të ulët se nota C gjatë kontrollit të cilësisë së punës nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
- d. Të ketë mbi 7 (shtatë) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave/subjekteve financiare të aprovuara sipas kuadrit ligjor në fuqi ose autoritete rregullatore financiare që aplikojnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve);
- e. Shoqëria e auditimit duhet të ketë një ekip me kualifikime dhe eksperiencë profesionale të përshtatshme për të ofruar shërbime të niveleve më të larta. Drejtuesi i ekipit që do të angazhohet në auditimin e Autoritetit duhet të ketë titullin Ekspert Kontabël i Regjistruar, si edhe titullin ndërkombëtar ACCA/CPA. Dy anëtarë të tjerë të ekipit duhet të kenë jo më pak se katër vjet eksperiencë pune në auditim dhe të kenë certifikata profesionale ndërkombëtare ose kombëtare në fushën e auditimit dhe/ose të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- f. Shoqëria e auditimit duhet të jetë e pavarur në realitet dhe në dukje në kryerjen e funksionit të tij dhe të mos ketë konflikt interesash me Autoritetin, sipas përcaktimeve të ligjit “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar;
- g. Shoqëria e Auditimit të mos ketë qenë subjekt në pesë vitet e fundit, e një mase disiplinore të vendosur nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, në përputhje me Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” i ndryshuar.